

RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR
MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PER QELLIME TE VECANTA

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA
NGA PARTIA LEVIZJA PUNETORE SHQIPTARE

PER KOMISIONIN QENDROR ZGJEDHOR

Te nderuar zoterinj,

te KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Bulevardi "Deshmoret e Kombit"

Pallati i Kongreseve

Tirane

Une, Stoli Laze në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar (Audit i pavarur) jam caktuar me Vendimin Nr 06 date 04.04.2012 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve per kryerjen e auditimit te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga Partia Levizja Punetore Shqiptare per vitin kalendarik 2011.

Ne kemi audituar dokumentacionin financiar e kontabel qe lidhet me fondet e perfituara dhe te shpenzuara per vitin kalendarik 2011, periudhe kjo e cila fillon me 01.01.2011 dhe mbaron 31.12.2011. Ne kete auditim jane audituar fondet e perfituara dhe te shpenzuara pergjate gjithe vitit nga Partia Levizja Punetore Shqiptare duke u bazuar ne ligjin nr.10019 date 29.02.2008 dhe ligjin nr. 10374 date 10.02.2011.

Pergatitja e ketij dokumentacioni eshte pergjegjesi e drejtuesve te Partise Levizja Punetore Shqiptare.

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi fondet e shpenzuara dhe audituara bazuar ne auditimin tone.

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te auditimit (SNA 800) Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditimin per te zoteruar siguri te arsyshme, se keto pasqyra nuk permbajne anomali materjale. Auditimi perfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare qe



perfshin : Libri i llogarive te subjektit , Regjistri i posacem i miratuar si model me vendim te KQZ-se si dhe Pasqyra e arketim pagesave.

Auditimi perfshin gjithashtu , vlersimin e parimeve kontabel te ndjekura dhe vlersimet e rendesishme te bera nga drejtimi, si edhe vlersimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyres.

Ne cmojme se auditime yne perben nje baze te arsyshme per te shprehur opinionin tone.

Politika kontabel e ndjekur nga ana e subjektit zgjedhor eshte te pergatise pasqyrat bashkalidhur mbi bazen e arketimeve dhe pagesave. Mbi kete baze , e ardhura eshte njohur ne momentin e arketimit dhe shpenzimet ne momentin e pagesave.

Per mendimin tone , pasqyrat bashkalidhur japin nje pamje te vertete e te sinqerte te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara (paguara) nga subjekti zgjedhor (entiteti) gjate vitit kalendarik 2011, qe fillon me 01.01.2011 dhe mbyllet me 31.12.2011, ne perputhje me bazen e arketimeve dhe pagesave , sic pershkruhet ne shenimet bashkalidhur.

Raporti u hartua mbeshtetur ne pasqyrat bashkalidhur.

Tirane 16.06.2012

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Stoli LAZE

